

ASISTENCA PER MJEDISIN GLOBAL(GEF)

RUAJTJA E LIQENIT TE OHRIT

Statusi	Në zbatim
Huamarrësi	Republika e Shqipërisë (bashkë me Republikën Ish-Jugosllave të Maqedonisë)
Kostoja e projektit	US\$ 4.28 milionë (total)
Shuma e Grantit GEF dhe së AMG	US\$ 1.78 milionë (total US\$ 3.97 milionë)
Data e nënshkrimit	6 gusht 1998
Data e bërjes efektive	3 dhjetor 1998
Data e mbylljes	30 qershor 2002

□ Objektivat e projektit

Objektivi kryesor i projektit është zhvillimi i bazave për administrimin dhe mbrojtjen e përbashkët të Liqenit të Ohrit nga qeveritë dhe popujt e dy vendeve, Shqipërisë dhe Maqedonisë. Duke krijuar një bazë për administrimin e përbashkët të ujëmbledhësit të liqenit të Ohrit, projekti nxit zgjidhjet me kosto efikase për problemet e menaxhimit të burimeve natyrore ndërkufitare dhe problemin e ndotjes, si edhe siguron një bazë për një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm të ujëmbledhësit.

□ Përshkrimi i projektit

Projekti përbëhet nga katër komponentët e poshtëpërmendur. Granti i GEF në mbështetje të zbatimit të projektit do të financojë pajisjet, stafin dhe konsulentët, studimet dhe projektet pilote, ndërgjegjësimin publik dhe programet trajnuese të nevojshme për zbatimin e aktiviteteve të komponentëve në një periudhë 3-vjeçare. Komponentët janë: (i) forcimi institucional; (ii) monitorimi i Liqenit të Ohrit; (iii) administrimi i ujëmbledhësit dhe (iv) ndërgjegjësimi dhe pjesëmarrja publike.

□ Arritjet e projektit

Te gjithë komponentet e projektit po bejne nje progres te mire, dhe projekti ka qene i suksesshem ne zhvillimin e bashkepunimit nderkufitar per mbrojtjen e Liqenit te Ohrit. Bordi Drejtues shqiptaro-maqedonas, i krijuar në vazhdën e këtij projekti, po nxit dhe harmonizon legjislacionin për ruajtjen dhe menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve liqenore, midis dy vendeve, me një vemendje të veçantë tek rregullat e peshkimit. Bordi dhe Ministrite e Mjedisit te te dyja vendeve aktualisht jane duke punuar per pergatitjen e nje marreveshjeje nderkombetare per mbrojtjen dhe menxhimin e burimeve te liqenit. Laboratori i ri analizues i krijuar në Pogradec tani funksionon me kapacitet te plote pune dhe eshte duke i dhene mbeshtetje programit te monitorimit dhe nxjerrjes se kampioneve.

□ **Disbursimi**

US\$ 1.4 milion (dhjetor 2002)

Personat e kontaktit

Drejtues programi: Aleksandar Nacev, Zyra e Bankës Botërore ne Shkup,
Tel: 389 91 117 627; e-mail: anacev@worldbank.org

Drejtues projekti në zyrën e Tiranës Drita Dade, Zyra e Bankës Botërore Tiranë, Tel 355-42-87/88/89;
Faks: 355-42-40590; e-mail: ddade@worldbank

Personi i kontaktit në qeveri Lirim Selfo, Koordinator projekti, Konsulent,
Tel: 355-42-42738